

kanë gjetur trupin e pajetë të babait. Ilazin e varrosën në varrezat e fshatit Kaçandoll/Kaçandol.

**Burimet:** deklarata F.H, FDH-30720; FDH, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XX, 194; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092.

## Rrahim (Kadri) Lepaja

(6.02.1967, shqiptar nga Bajçina/Bajçina, komuna e Podujevës/Podujevo, i papunë, një fëmijë)

## Beqir (Xhafer) Lepaja

(6.12.1971, shqiptar nga Bajçina/Bajçina, komuna e Podujevës/Podujevo, i papunë, i pamartuar)

Në datën 15.09.1998, rreth orës 9:30, forcat serbe nga pozicioni përmbi *Mëhallën* e *Lepajës* kishin filluar granatimin e fshatrave Dobratin/Dobrotin dhe Kaçandoll/Kaçandol. Rreth orës 12:00, nga *Mëhalla Lepaja*, 60 familje u nisën me traktorë për ta braktisur fshatin, por forcat serbe e kishin kthyer vargun e njerëzve nga rruga kryesore në drejtim të fshatit Dobratin/Dobrotin. Në mbrëmje, të gjithë kaluan në mëhallën e *Çitakëve* në Bajçinë/Bajçina [Podujevë/Podujevo]. Në të njëjtën natë, Beqiri dhe Rrahimi shkuan te vëllezërit e Beqirit në Podujevë/Podujevo. Dy ditë më vonë, më **17.09.1998**, Beqiri, Rrahimi dhe vëllai i tij Rrustemi vendosën për t'i vizituar shtëpitë. Rreth orës 13:30, mbërritën afro 700 metra larg nga mëhalla e tyre. Dëgjuan të shtëna të fuqishme, por nuk kishin parë pjesëtarë të forcave serbe. Rrahimi dhe Beqiri u nisën në drejtim të shtëpive, ndërsa Rrustemi mbeti për t'i pritur ata pas një kodre. Rreth orës 14:00, e kishte parë një *Golf* me shenja të auto shkollës, duke lëvizur në drejtim të shtëpisë së Hazir Rekaliut, kurse rreth orës 15:30, shtëpinë e Hazirit e kaploi zjarri. Pas tërheqjes së forcave serbe, trupat e pajetë të Beqirit dhe Rrahimit u zbuluan në shtëpinë e djegur të Hazirit [**Bajçinë/Bajçina**]. Familjarët i kishin identifikuar në bazë të rrobave dhe gjësendeve personale. Beqiri dhe Rrahimi u varrosën më 21.09.1998 në varrezat e *Mëhallës Lepajë*, në fshatin Bajçinë/Bajçina.

**Burimet:** deklarata Rr.L, FDH-36773; deklarata V.F, FDH-11755; deklarata Xh.A, FDH-35228; *Two of the Six Burned Albanians Identified*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.09.1998, FDH-29567; *Identity of Four Other Burned Albanians in Podujeva Established*, pasqyra e lajmeve, KIC, 22.09.1998, FDH-29568.

## Ukshin (Abdullah) Ferati

(2.04.1959, shqiptar nga fshati Bare, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, punëtor, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ukshini ka punuar në Fabrikën e Lëkurës në Bare. Ai, bashkëshortja dhe tre fëmijë të tyre jetonin në bashkësi familjare me tre vëllezërit e Ukshinit dhe nënën Nazifen. Në qershor të vitit 1998, Ukshini dhe i vëllai Fetahu aderuan në njësitin e UÇK-së në këtë fshati. Në datën **16.09.1998**, forcat serbe filluan që t'i afroheshin këtij fshati, kështu që popullata u detyrua të largohej. Ukshini e braktisi njësitin e vet dhe erdhi në shtëpi për tu informuar për fatin e familjes. Më pas erdhi edhe Fetahu, i cili menjëherë u kthye në njësitin e tij, kurse Ukshini kishte thënë se do të shkonte deri në fshatin Kaçandoll/Kaçandol, për tu takuar me familjen e vet. Atë ditë forcat serbe kanë hyrë në fshat [**Bare**]. Kishte luftime në mes të forcave serbe dhe atyre shqiptare. Forcat serbe i kishin djegur shtëpitë, kurse UÇK-ja ishte tërhequr në pyllin *Barel/Barelj*. Dy ditë më vonë, Fetahu me dy ushtarë të UÇK-së u kthyen në fshat. Shtëpia ishte e djegur, ndërsa për Ukshinin nuk dinin asgjë. Për fatin e Ukshinit, familjarët një kohë të gjatë nuk kishin kurrfarë njohurish. Në fillim të muajit maj të vitit 2005, familjarët kanë mësuar se pjesëtarët e KFOR-it, në vitin 2002, në pyllin e fshatit Bare, i kanë gjetur mbetjet mortore, për të cilat me analizën e ADN-së u konstatua se u takonin Ukshin Feratit. Në datën 12.05.2005, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Ukshinit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Shipol/Šipolje.

**Burimi:** deklarata F.F, FDH-17348.

## Boris (Alojz) Plahuta

(28.06.1968, serb nga Bajina Bashta, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)